



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Drejtoria e Përgjithshme

Nr. 2110 Prot.

Tiranë, më 04.05 .2018

UDHËZIM

Nr. 04 , datë 04.05.2018

PËR

**“KUFIZIMET E PËRDORIMIT TË BARNAVE TË LISTËS SË
BARNAVE TË RIMBURSUARA 2018”**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 218 datë datë 20.04.2018, “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe të masës së mbulimit të çmimit të tyre”, Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Fondit nr. 323, datë 03.05.2018 “Për caktimin e kufizimeve në përdorimin, sasinë dhe kohëzgjatjen e trajtimit të barnave të Listës së Barnave të Rimbursueshme nga Fondi”, me qëllim trajtimin shëndetësor të pacientëve në një formë sa më të efektshme, rezultative dhe kostoefektive me barnat e Listës së Barnave që Rimbursohen nga Fondi,

UDHËZOJ:

1. Të gjitha barnat e Listës së Barnave të Rimbursuara 2018 do të përshkruhen në recetën me rimbursim nga mjekët e kontraktuar, sipas emrit xhenerik, sipas formë-dozës dhe duke zbatuar kufizimet përkatëse të vendosura në LBR 2018.
2. Trajtimi ambulator me barna për kategorinë “Invalid lufte” dhe “Veteran” do të vazhdojë të bëhet në zbatim të VKA Nr. 18, Datë 23/06/2006 dhe Udhëzimit të ISKSH Nr. 9, Datë 19/07/2006 “Për zbatimin e kufizimeve të barnave të listës së rimbursueshme për invalidët dhe veteranët e luftës”.
3. Në të gjitha rastet kur kufizimi i Listës së Barnave citon “Sipas protokollit të Fondit”, mjekët duhet të përshkruajnë barnat në recetën me rimbursim, duke zbatuar kriteret e përcaktuara në protokollin e përdorimit të barnave, të dërguara nga Fondi.

4. Në të gjitha rastet kur kufizimi i Listës së Barnave përmban shënimin "me konsultë specialisti", ose "konsultë të Shërbimit QSUT", të kërkohet konsulta përkatëse në rastet kur fillohet mjekimi për herë të parë, kur ndryshohet mjekimi, kur kërkohet nga vetë konsulta për rikontroll dhe në raste të tjera sa herë mjeku i familjes e gjykon të nevojshme.
5. Barnat e Listës do të përshkruhen në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes, si dhe nga mjekët specialistë të QSUT apo të spitaleve rajonale/bashkiake, të cilët janë të kontraktuar me Fondin/DRFSDKSH.

A. Barna të Listës ekzistuese 2016 që përfshihen dhe në LBR 2018

1. Për Barnat **Insulinë Humane Biosintetike Neutrale dhe Izofane**, kufizimi do të jetë:
 - a. "Deri në 8 pena në muaj nga të gjitha insulinat me konsultë të mjekut endokrinolog, mbi 8 deri 12 pena nga të gjitha insulinat me konsultë QSUT, mbi 12 pena nga të gjitha insulinat shtrim në QSUT".
 - b. Këto barna do të përshkruhen në recetën me rimbursim nga mjeku i përgjithshëm dhe familjes, kundrejt konsultës së endokrinologut, deri në 8 pena në muaj, nëse i sëmurit ka nevojë për më tepër se 8 dhe deri në 12 pena nga grupi i insulinave të sipërcituara, rekomandohet për të gjykuar ecurinë e sëmundjes, gjendjen klinike të sëmurit dhe nevojat e tij për të mbajtur në ekuilibër diabetin ose dërgohet për konsultë në QSUT.
 - c. Mbi 12 pena nga të gjitha insulinat dërgohet për shtrim në QSUT për të ndjekur pacientin në nivel terciar.
2. Në trajtimin e të sëmurëve **diabetike insulinovartës** të mbahet parasysh:
 - a. Në rast se për trajtimin e të sëmurit rekomandohet nga konsulta përkatëse ose shtrimi kombinimi i dy insulinave analoge, sasia e penave për secilën prej insulinave që do të përshkruhet në recetën me rimbursim, të llogaritet sipas kufizimit përkatës të secilës prej këtyre insulinave.
 - b. Në rast se për trajtimin e të sëmurit rekomandohet nga konsulta përkatëse kombinimi i insulinave, nga grupi i analogeve dhe nga grupi i insulinave humane biosintetike, atëherë sasia e penave për secilën prej insulinave që do të përshkruhet në recetën me rimbursim, të llogaritet sipas kufizimit përkatës për secilin lloj të insulinave.
3. Të sëmurët ku spitali bashkiak nuk ka endokrinolog, do të dërgohen në zbatim të sistemit të referimit në spital rajonal. Në mungesë të specialistit endokrinolog në rajon, të sëmurët do të dërgohen në rajonin më të afërt. Mjeku i familjes në bashkëpunim me mjekun endokrinolog duhet të mbajnë nën kontroll të sëmurin në varësi të shifrave të glicemisë esëll dhe 2 orë pas ushqimit dhe të HbA1c, duke racionalizuar përdorimin e sasive të larta të insulinës.
4. Bari **Insuline Humane Biosintetike Neutrale 100 Nj.N. / ml - 3 ml** do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Deri në 8 pena në muaj nga të gjitha insulinat me konsultë endokrinologu, mbi 8-12 pena nga të gjitha insulinat me Konsultë QSUT, mbi 12 pena nga të gjitha insulinat shtrim në QSUT"*.

5. **Bari Insuline Aspart solution 100 Nj.N/ml - 3 ml**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Deri në 4 pena në muaj, mbi 4 pena me konsultë QSUT"*. Të drejtën e rekomandimit deri në 4 pena e ka mjeku specialist endokrinolog, mbi 4 pena insulinë do të jepen nga konsulta e QSUT.
6. **Bari Insuline Glulisine 100 N.Nj - 3 ml**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Deri në 4 pena në muaj, mbi 4 pena me Konsultë QSUT"*. Të drejtën e rekomandimit deri në 4 pena e ka mjeku specialist endokrinolog, mbi 4 pena insulinë do të jepen nga Konsulta e QSUT.
7. **Bari Insuline Humane Biosintetike Izofane 100 Nj.N. / ml - 3 ml** do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Deri në 8 pena në muaj nga të gjitha insulinat me konsultë endokrinologu, mbi 8-12 pena nga të gjitha insulinat me Konsultë QSUT, mbi 12 pena nga të gjitha insulinat shtrim në QSUT"*.
8. **Bari Insuline Humane Biosintetike Bifazike Izofane 100 Nj.N. / ml - 3 ml** do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Deri në 8 pena në muaj nga të gjitha insulinat me konsultë endokrinologu, mbi 8-12 pena nga të gjitha insulinat me Konsultë QSUT, mbi 12 pena nga të gjitha insulinat shtrim në QSUT"*.
9. **Bari Insuline Aspartan + Protamine Crystallised Ins Aspart 100 NjN/ml - 3 ml 30/70**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Deri në 4 pena në muaj, mbi 4 pena me Konsultë QSUT"*. Të drejtën e rekomandimit deri në 4 pena e ka mjeku specialist endokrinolog, mbi 4 pena insulinë do të jepen nga Konsulta e QSUT.
10. **Bari Insuline Glargine solution 100 Nj.N/ml - 3 ml**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Deri në 3 pena në muaj, mbi 3 pena me Konsultë QSUT"*. Të drejtën e rekomandimit deri në 3 pena e ka mjeku specialist endokrinolog, mbi 3 pena insulinë do të jepen nga Konsulta e QSUT.
11. **Bari Insulin Glargine 300 Nj.N./ml**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Deri në 2 pena me konsultë të mjekut endokrinolog, mbi 2 pena Konsultë në QSUT"*. Të drejtën e rekomandimit deri në 2 pena e ka mjeku specialist endokrinolog, mbi 2 pena insulinë do të jepen nga Konsulta e QSUT.
12. **Bari Insuline Detemir solution 100 Nj.N/ ml - 3 ml**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Deri në 3 pena në muaj, mbi 3 pena me Konsultë në QSUT"*. Të drejtën e rekomandimit deri në 3 pena e ka mjeku specialist endokrinolog, mbi 3 pena insulinë do të jepen nga Konsulta e QSUT.
13. **Bari Iron(III) Hydroxide Dextra Complex 100mg/2ml**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Vetëm në anemi sekondare nga IRK. Me konsultë të Nefrologut në spitalin rajonal"*.

14. **Bari Iron (III) Hydroxide Dextra Complex 100mg/5ml**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Vetëm në anemi sekondare nga IRK. Me konsulte të Nefrologut në spitalin rajonal"*.
15. **Bari Moxonidine 0.4 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Në HTA të shoqëruar me IRK. Me konsultë të nefrologut të spitalit rajonal. Deri në 30 tabl. në muaj"*.
16. **Bari Anastrozole 1 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Fillimi i mjekimit me konsultë të shërbimit Onkologjik të QSUT, vazhdimi i mjekimit me konsultë onkologu të spitalit rajonal. Deri në 30 tabl. në muaj"*. Konsulta e QSUT do të kërkohet nga mjeku i familjes vetëm për fillimin e mjekimit me këtë bar, vazhdimësia do të jetë nga mjeku onkolog i spitalit rajonal.
17. **Bari Letrozole 2.5 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Fillimi i mjekimit me konsultë të shërbimit Onkologjik të QSUT, vazhdimi i mjekimit me konsultë onkologu të spitalit rajonal. Deri në 30 tabl. në muaj"*. Konsulta e QSUT do të kërkohet nga mjeku i familjes vetëm për fillimin e mjekimit me këtë bar, vazhdimësia do të jetë nga mjeku onkolog i spitalit rajonal.
18. **Bari Pregabalin 75 mg, bari Pregabalin 150 mg dhe bari Pregabalin 300 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Në Epilepsinë Rezistente. Fillimi i mjekimit me konsultë të neurologut, neuropediatrit të QSUT, vazhdimi i mjekimit me konsultë neurologu, neuropediatrit të spitalit rajonal"*. Konsulta e QSUT do të kërkohet nga mjeku i familjes vetëm për fillimin e mjekimit me këtë bar, vazhdimësia do të jetë nga mjeku neurolog/neuropediatër i spitalit rajonal.
19. **Bari Paliperidone 6 mg dhe Paliperidone 9 mg** do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Me konsultë të mjekut psikiatër"*.
20. **Bari Somatropinë 5 mg (15 Nj.N) dhe 12 mg (36 Nj.N) pen**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Sipas protokollit të përdorimit të barit të dërguar nga Fondi. Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësive të mjekut të Endokrinologjisë Pediatricë të QSUT"*.
21. **Bari Acenokumarol 4 mg** do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Sipas protokollit të dërguar nga Fondi"*.
22. **Bari Desmopressin 001 mg/ml**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Në Diabetin Insipid dhe për trajtimin e enurezës nocturna dhe polidipsisë pas operacioneve të hipofizës"*.
23. **Bari Rivaroxaban 10 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Për trajtimin e trombozave të venave të thella pas kirurgjisë madhore të gjymtyrëve të poshtme. Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësive të mjekut të Shërbimit të Ortopedisë në QSUT"*.

24. Bari **Rivaroxaban 20 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Në pacientët me fibrilacion atrial jovalvular që sipas sistemit Chads2score të kenë nivelin e pikëzimit ≥ 3 pikë, kur antikoagulantët e tjerë nuk veprojnë. Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësive e mjekut të Shërbimit të Kardiologjisë/Neurologjisë në QSUT. Deri në 30 tableta në muaj"*.

Sistemi Chads2score tek pacientët me Fibrilacion atrial (FA) ka këto kritere të pikëzuara si më poshtë:

1. Stroke/TIA i kaluar	2 pikë
2. Insuf. Kardiake	1 pikë
3. HTA	1 pikë
4. Moshë ≥ 75 vjeç	1 pikë
5. Diabeti mellitus	1 pikë

Për pacientët që janë nën trajtim me këtë bar dhe nuk plotësojnë sistemin e pikëzimit sipas sistemit Chads2score, duhet të rikonsultohen pranë mjekut specialist përkatës për të përcaktuar skemën e mjekimit më të përshtatshme për pacientin në zbatim të kufizimeve të LBR 2018.

25. Bari **Ledipasvir + Sofosbuvir 90 + 400 mg film coated tablet**, do të përshkruhen në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Në pacientët me Hepatit C të të gjitha genotipeve të shoqëruar me cirrozë hepatike dhe shkallë të fibrozës së avancuar F3-F4. Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësive e mjekëve të Shërbimit të Gastrohepatologjisë në QSUT"*.
26. Bari **Dasabuvir 250 mg tablet** dhe bari **Ombitasvir + Paritaprevir + Ritonavir (12,5 + 75 + 50) mg film coated tablet**, do të përshkruhen në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Në pacientët me Hepatit C të të gjitha genotipeve të shoqëruar me cirrozë hepatike dhe shkallë të fibrozës së avancuar F3-F4. Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësive e mjekëve të Shërbimit të Gastrohepatologjisë në QSUT"*.
27. Bari **Sofosbuvir 400 mg tablet**, do të përshkruhen në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Në pacientët me Hepatit C të të gjitha genotipeve të shoqëruar me cirrozë hepatike dhe shkallë të fibrozës së avancuar F3-F4. Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësive e mjekëve të Shërbimit të Gastrohepatologjisë në QSUT"*.
28. Bari **Infliximab 100 mg pluhur për inj**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Për pacientë me Kollit Ulçeroz dhe Morbus Crohn. Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësive e mjekëve të Shërbimit të Gastro Hepatologjisë në QSUT"*. Pacientët që janë në trajtim me këtë bar për diagnoza të tjera, duhet të rikonsultohen pranë mjekut specialist përkatës për të përcaktuar skemën e mjekimit më të përshtatshme për pacientin në zbatim të kufizimeve të LBR 2018.

29. Bari **Etanercept 25 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Për pacientë me Arthritin Idiopatik Juvenil. Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësive të mjekëve të Shërbimit të Pediatriisë së Përgjithshme në QSUT"*. Pacientët që janë në trajtim me këtë bar për diagnoza të tjera, duhet të rikonsultohen pranë mjekut specialist përkatës për të përcaktuar skemën e mjekimit më të përshtatshme për pacientin në zbatim të kufizimeve të LBR 2018.
30. Bari **Etanercept 50 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Për pacientë me Arthritin Idiopatik Juvenil. Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësive të mjekëve të Shërbimit të Reumatologjisë"*. Pacientët që janë në trajtim me këtë bar për diagnoza të tjera, duhet të rikonsultohen pranë mjekut specialist përkatës për të përcaktuar skemën e mjekimit më të përshtatshme për pacientin në zbatim të kufizimeve të LBR 2018.
31. Bari **Adalimumab 40 mg/0.8ml pre-filled syringe**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Në Arthritin Idiopatik Juvenil të formës së rëndë. Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësive të mjekëve pediatër-rheumatolog të Shërbimit të Pediatriisë së Përgjithshme / Reumatologjisë në QSUT"*. Pacientët që janë në trajtim me këtë bar për diagnoza të tjera, duhet të rikonsultohen pranë mjekut specialist përkatës për të përcaktuar skemën e mjekimit më të përshtatshme për pacientin në zbatim të kufizimeve të LBR 2018.
32. Bari **Tofacitinib Citrate 5 mg film coated tablet**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Në artrit rheumatoid shumë të rëndë që nuk i përgjigjet metotrexatit, dhe vetëm kur vërtetohet se pacienti nuk vuan nga ndonjë infeksion (bakterial ose viral), nuk merr mjekim për ndonjë infeksion, dhe nuk ka sistem imunitar të kompromentuar. Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësive të mjekëve të Shërbimit të Reumatologjisë në QSUT"*. Ky bar përdoret vetëm për pacientët që nuk kanë qenë ndonjëherë nën trajtim me barna biologjike të sipërpërmendura.
33. Bari **Allibercept 40 mg/ml tret.per inj.** do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Në trajtimin e Edemës makulare diabetike (DMO). Trajtim nga personel i specializuar i Edemës makulare si pasojë e Okluzionit Venoz ose Arterial Retinal. Deri në 1 vit mjekim. Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësive të mjekëve të Shërbimit të Okulistikës në QSUT"*. Pacientët që janë në trajtim me këtë bar për diagnoza të tjera, duhet të rikonsultohen pranë mjekut specialist përkatës për të përcaktuar skemën e mjekimit më të përshtatshme për pacientin në zbatim të kufizimeve të LBR 2018.
34. Bari **Ranibizumab 10 mg/ml tret. për.inj.** do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Në trajtimin e Edemës makulare diabetike (DMO). Trajtim nga personel i specializuar i degjenerimit macular neovascular eksudativ. Deri në 1 vit mjekim. Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësive të mjekëve të Shërbimit të Okulistikës në QSUT"*.
35. Bari **Ranolazinë 375 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Në të sëmurët me sëmundje të qëndrueshme të arterieve koronare, të shoqëruar me Diabet Mellitus, që kanë kryer angioplastikë"*. Pacientët që janë në trajtim me këtë bar dhe nuk plotësojnë kushtet e mësipërme, duhet të rikonsultohen pranë mjekut specialist përkatës për të përcaktuar skemën e mjekimit më të përshtatshme për pacientin në zbatim të kufizimeve të LBR 2018.

36. Bari **Ranolazinë 500 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: "*Në të sëmurët me sëmundje të qëndrueshme të arterieve koronare, të shoqëruar me Diabet Mellitus, që kanë kryer angioplastikë*". Pacientët që janë në trajtim me këtë bar dhe nuk plotësojnë kushtet e mësipërme, duhet të rikonsultohen pranë mjekut specialist përkatës për të përcaktuar skemën e mjekimit më të përshtatshme për pacientin në zbatim të kufizimeve të LBR 2018.
37. Bari **Ranolazinë 750 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: "*Në të sëmurët me sëmundje të qëndrueshme të arterieve koronare, të shoqëruar me Diabet Mellitus, që kanë kryer angioplastikë*". Pacientët që janë në trajtim me këtë bar dhe nuk plotësojnë kushtet e mësipërme, duhet të rikonsultohen pranë mjekut specialist përkatës për të përcaktuar skemën e mjekimit më të përshtatshme për pacientin në zbatim të kufizimeve të LBR 2018.
38. Bari **Salmeterol Xinafoate Micronised + Fluticasone Propionate (50 mcg + 100 mcg)/ unit dose**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: "*Në A. Bronchiale forma e rëndë. Me Konsultë alergologu, pneumologu, specialisti të S. Profesionale. Deri në 1 flakon në muaj*". Pacientët që janë në trajtim me këtë bar për diagnoza të tjera, duhet të rikonsultohen pranë mjekut specialist përkatës për të përcaktuar skemën e mjekimit më të përshtatshme për pacientin në zbatim të kufizimeve të LBR 2018.
39. Bari **Salmeterol Xinafoate Micronised + Fluticasone Propionate (50 mcg + 250 mcg)/ unit dose**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: "*Në A. Bronchiale forma e rëndë. Me Konsultë alergologu, pneumologu, specialisti të S. Profesionale. Deri në 1 flakon në muaj*". Pacientët që janë në trajtim me këtë bar për diagnoza të tjera, duhet të rikonsultohen pranë mjekut specialist përkatës për të përcaktuar skemën e mjekimit më të përshtatshme për pacientin në zbatim të kufizimeve të LBR 2018.
40. Bari **Salmeterol Xinafoate Micronised + Fluticasone Propionate (50 mcg + 500 mcg)/ unit dose pomp**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: "*Në A. Bronchiale forma e rëndë. Me Konsultë alergologu, pneumologu, specialisti të S. Profesionale. Deri në 1 flakon në muaj*". Pacientët që janë në trajtim me këtë bar për diagnoza të tjera, duhet të rikonsultohen pranë mjekut specialist përkatës për të përcaktuar skemën e mjekimit më të përshtatshme për pacientin në zbatim të kufizimeve të LBR 2018.
41. Bari **Beclometasone + Formaterol 100/6 mcg 120 doza** do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: "*Në Astma Bronchiale. Me konsultë të Komisionit Rajonal të Pneumologjisë. Deri në 1 fl në muaj*". Pacientët që janë në trajtim me këtë bar për diagnoza të tjera, duhet të rikonsultohen pranë mjekut specialist përkatës për të përcaktuar skemën e mjekimit më të përshtatshme për pacientin në zbatim të kufizimeve të LBR 2018

B. Barna të reja të LBR 2018

1. Bari **Ribociclib 200 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Vetëm në Ca gjiri metastatik, HR+ / PR + / HER2 (0), çdo T, çdo N, M1. Me konsultë të Shërbimit të Onkologjisë në QSUT"*
2. Bari **Ivabradine 5 mg** dhe **Ivabradine 7.5 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Në pacientët me angina pectoris kronike të qëndrueshme që kanë kundërrindikacion për betablokues, rezistente ndaj mjekimit me barnat të të njëjtit grup. Me konsultë të kardiologu. Deri në 30 tableta në muaj"*.
3. Bari **Apomorphine 10 mg/3 ml** dhe **727/430 Apomorphine 5 mg/10 ml**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Në të sëmurët me Parkinson që nuk kontrollohen nga barnat e tjerë. Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësive e mjekut neurolog në punktin extrapiramidal në QSUT"*
4. Bari **Elbasvir + Grazoprevir 50 mg+ 100 mg** do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Në pacientët me Hepatit C të të gjitha genotipeve të shoqëruar me cirrozë hepatike dhe shkallë të fibrozës së avancuar F3-F4. Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësive e mjekëve të Shërbimit të Gastrohepatologjisë në QSUT"*.
5. Bari **Apixaban 2.5 mg** dhe **Apixaban 5 mg** do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Në pacientët me fibrilacion atrial jovalvular që sipas sistemit Chads2score të kenë nivelin e pikëzimit ≥ 3 pikë, kur antikoagulantët e tjerë nuk veprojnë. Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësive e mjekut të Shërbimit të Kardiologjisë/Neurologjisë në QSUT. Deri në 30 tableta në muaj"*.

Sistemi Chads2score tek pacientët me Fibrilacion atrial (FA) ka këto kritere të pikëzuara si më poshtë:

1. Stroke/TIA i kaluar	2 pikë
2. Insuf. Kardiake	1 pikë
3. HTA	1 pikë
4. Moshë ≥ 75 vjeç	1 pikë
5. Diabeti mellitus	1 pikë

6. Bari **Meldonium 250 mg** dhe **Meldonium 500 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Në të sëmurët me sëmundje të qëndrueshme të arterieve koronare, që kanë kryer angioplastikë. Me konsultë kardiologu. Deri në 30 tableta në muaj"*
7. Bari **Potassium Iodide 200 mcg** tabletë, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Për fëmijë 0-6 vjeç. Në trajtimin dhe parandalimin e pamjaftueshmërisë jodike"*.

8. Bari **Ibrutinib 140 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Në Neoplazi Myeloproliferative, Leukemia Myeloide Kronike, pas dështimit me Nilotinib. Me Konsultë të mjekëve të Shërbimit të Hematologjisë në QSUT"*.
9. Bari **Donepezil Hydrochloride 5 mg** dhe **Donepezil Hydrochloride 10 mg** do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Në trajtimin e demencës në të sëmurë me Alzheimer, të cilët nuk vuajnë me Diabet Mellitus. Deri në 2 vjet mjekim. Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësive të mjekëve të Shërbimit të Neurologjisë në QSUT"*.
10. Bari **Methylprednisolone aceponate 0.1 % - 100 g, 5g; dhe Methylprednisolone aceponate x 0.1 g / 100 g, 15g C**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Deri në 1 tubet në muaj"*.
11. Bari **Leflunomide 20 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Arthrit Reumatoid Stadi III rezistent ndaj mjekimeve të tjera. Me konsultë reumatologu"*.
12. Bari **Zofenopril 30 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Post Infarkt akut miokardi, në pacientë IKK me fraksion hedhjeje nën 40 %. Deri në 30 tableta në muaj, Me konsultë kardiologu."*
13. Bari **Paliperidone 75 mg, Paliperidone 100 mg dhe Paliperidone 150 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Në skizofreni rezistente ndaj psikoleptikëve të tjerë të LBR. Me konsultë dhe nën përgjegjësive të mjekut të Shërbimit të Psikiatrisë në QSUT/ Të mjekëve psikiatër të spitaleve rajonale ku tregëtohet ky bar"*. Rastet e reja, ndryshimet e terapive duhet të jenë nën monitorimin dhe përgjegjësive të Konsultës së Shërbimit përkatës në QSUT/ mjekëve psikiatër të spitaleve rajonale.
14. Bari **Ramipril 5 mg** dhe **Ramipril 10 mg** do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Në trajtimin e HTA të shoqëruar me IKK ose IRK. Me konsultë kardiologu"*.
15. Bari **Liraglutide 6 mg/ml** do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Në Diabet Mellitus tip 2 të tipit të rëndë pas dështimit të mjekimit me antidiabetikët e tjerë oralë me Konsultë të Shërbimit të Endokrinologjisë në QSUT. Deri në 2 pena në muaj"*.
16. Bari **Trastuzumab 600 mg/5 ml**; do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Vetëm në Ca gjiri me HER 2 (3+), çdo T, çdo N, çdo M. Me konsultë të Shërbimit të Onkologjisë në QSUT"*.
17. Bari **Palbociclib 75 mg** dhe **Palbociclib 100 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Në kombinim me Letrozolin, nën monitorim të rreptë të rruazave të bardha (mbi 1000 mm 3), vetëm në Gradën e I-rë dhe deri në Gradën e dytë (referuar SPC të barit). Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësive të mjekut të Shërbimit të Onkologjisë në QSUT"*.

18. Bari **Deferasirox 125 mg dhe Deferasirox 500 mg**; do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Sipas protokollit të Fondit. Me konsultë të QSUT"*.
19. Bari **Sulfamethoxazole + Trimethoprim 800 mg + 160 mg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Sipas protokollit të Fondit"*.
20. Bari **Olmesartan Medoxomil + Amlodipine + Hydrochlorothiazide (40 mg + 10 mg + 25 mg)**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Sipas protokollit të Fondit, kur ACE-inhibitorët e tjerë nuk veprojnë. Me konsultë të kardiologut, nefrologut, endokrinologut. Deri në 30 tabl. në muaj"*.
21. Bari **Somatropinë 8 mg pen**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët specialistë të kontraktuar nga Fondi: *"Sipas protokollit përdorimit të barit të dërguar nga Fondi. Me konsultë dhe nën monitorimin e përgjegjësishëm e mjekut të Endokrinologjisë Pediatrike të QSUT"*.
22. Bari **Fluticasone propionate 500 mcg - 60 doza**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Në A. Bronchiale forma e rëndë. Me Konsultë alergologu, pneumologu, specialisti të S. Profesionale. Deri në 1 flakon në muaj"*.
23. Bari **Erythromycine 250 mg / 5 ml**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Për fëmijë deri në 10 vjeç, në infeksione bakteriale"*.
24. Bari **Indacaterol + Glycopyrronium 110 mcg / 50mcg**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Vetëm në pacientë me SPOK që kanë nevojë për trajtimin e kombinuar. Me Konsultë alergologu, pneumologu, specialisti të S. Profesionale. Deri në 30 kapsula në muaj"*.
25. Bari **Colecalciferol 14 400 NJN / ml pika nga goja**, do të përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes sipas kufizimit: *"Për fëmijë. 1 flakon në muaj"*.

C. Barna të tjerë të LBR 2018

Për barnat e tjera të LBR 2018 mbeten të njëjtat kufizime në përdorim, sasinë dhe kohëzgjatjen e trajtimit, si në listën e mëparshme 2016, duke respektuar përcaktimet e Udhëzimit të FSDKSH me Nr. 6, Datë. 25/03/2015, për "Përshkrimin dhe egzekutimin e recetës me rimbursim për të sëmurët kronikë".

Për barnat që në LBR kanë shënimin "Sipas protokollit të Fondit" do tu referohen protokolleve e përdorimit të barnave të dërguara nga Fondi dhe të hartuara nga Shërbimet përkatëse Universitare.

Barnat e LBR 2018, të cilave u mungon protokoll i përdorimit të tyre, nuk do të përshkruhen në recetat me rimbursim deri në pajisjen me protokollet e përdorimit të barnave që do të hartohen nga shërbimet univeristare dhe do të dërgohen nga Fondi.

Merrni masat e duhura për pajisjen dhe sqarimin e qendrave shëndetësore/ spitaleve / mjekëve me qëllim zbatimin e këtij udhëzimi.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Eduard Ahmeti



The image shows a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Eduard Ahmeti'. To the right of the signature is a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISE' at the top, 'FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KLIENTIT SHËNDETËSOR' around the perimeter, and 'TIRANË' at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.